



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:250733

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05840306

C.nr.1165/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve: V.D, M.K dhe V.S-R, që të gjithë nga fshati Krushë e Madhe, komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati S.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike për kompensim nga marrëdhënia e punës, vlera e objektit të kontestit 1,000.00 euro, jashtë seancës, më datën 20.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve V.D, M.K dhe V.S-R.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses V.D, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 331 ditë pune të ja paguajë shumën prej 662,00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 16.11.2023(data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit M.K, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 331 ditë pune të ja paguajë shumën prej 662,00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 16.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses V.S-R, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 331 ditë pune të ja paguajë

shumën prej 662,00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 16.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

- V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve, V.D, M.K dhe V.S-R, t’i paguajë shumën prej 228,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit V.D, M.K dhe V.S-R përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 16.11.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,000.00 euro. Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se paditësit V.D, M.K dhe V.S-R kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë si mësimdhënës në SHFMU “Nesimi Elshani” në fshatin Nagavc, Komuna e Rahovecit, e që për periudhën e kërkuar paditësve i ka takuar e drejta e kompensimit të ushqimit në punë dhe udhëtim sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 21.01.2021, por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 22.01.2021 e deri më 21.11.2022 dhe atë për paditësit: V.D, M.K dhe V.S-R për 331 ditë të prezencës në punë.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 16.05.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Ndërkaq kërkesat që dalin nga kontestet e marrëdhënies së punës fillimisht duhet të parashtrohen tek punëdhënësi. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësit i kanë shterur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Në këtë rast paditësit nuk kanë parashtruar kërkesë për kompensim pranë të paditurës. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësve pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, i ka kontestuar në tërësi vërtetimet për ditët e punës nga drejtori i shkollës.

E njëjta ka theksuar se paditësja V.D , me Aktgjykim të plotëfuqishëm të kësaj gjykate C.nr.739/2021, me numër të lëndës 2021:159628, të datës 12.01.2024, është kompensuar në emër të ushqimit në punë për periudhën 22.01.2021-17.04.2021. Po ashtu, paditësja V.S-R, me Aktgjykim të plotëfuqishëm të kësaj gjykate C.nr.925/2021, me numër të lëndës 2020:021007, të datës 14.12.2021.

Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 319/2022 i datës 29.11.2022, i lëshuar nga SHFMU “Nesimi Elshani” në fshatin Nagavc, Komuna e Rahovecit për paditësen V.D; kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 171/19, e datës 02.09.2019, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses V.D;

Për paditësin M.K, vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 321/2022 i datës 29.11.2022, i lëshuar nga SHFMU “Nesimi Elshani” në fshatin Nagavc, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit M.K;

Për paditësen V.S-R, vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 314/2022 i datës 29.11.2022, i lëshuar nga SHFMU “Nesimi Elshani” në fshatin Nagavc, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës si mësimdhënës me Nr. të protokollit 139/1, e datës 28.08.2019, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses V.S-R;

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditëst kanë të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit për periudhën e kërkuar kohore kanë prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 319/2022 i datës 29.11.2022, i lëshuar nga SHFMU “ Nesimi Elshani” në fshatin Nagavc, Komuna e Rahovecit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja V.D në periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 331 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 171/19, e datës 02.09.2019, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses V.D, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Nesimi Elshani” në fshatin Nagavc, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 321/2022 i datës 29.11.2022, i lëshuar nga SHFMU “Nesimi Elshani” në fshatin Nagavc, Komuna e Rahovecit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi M.K në periudhën kohore prej datës 22.01.2021e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 331 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunes së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit M.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Nesimi Elshani” në fshatin Nagavc, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 314/2022 i datës 29.11.2022, i lëshuar nga SHFMU “Nesimi Elshani” në fshatin Nagavc, Komuna e Rahovecit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja V.S-R në periudhën kohore prej datës 22.01.2021 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 331 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 139/1, e datës 28.08.2019, e lidhur ndërmjet Komunes së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses V.S-R, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Nesimi Elshani” në fshatin Nagavc, Komuna e Rahovecit.

Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 paragrafi 1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Sa i përket pretendimeve të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësja V.D, me Aktgjykim të plotëfuqishëm të kësaj gjykate C.nr.739/2021, me numër të lëndës 2021:159628 të datës 12.01.2024, është kompensuar në emër të ushqimit në punmë, për periudhën 22.01.2021-17.04.2021, këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi që gjykata ka verifikuar që nuk bëhet fjalë për personin e njëjtë sepse Valbone Duraku e cila është kompensuar, punon në SH.M.L “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec.

Po ashtu, sa i përket pretendimeve të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësja V.S-R, me aktgjykimin e plotëfuqishëm të kësaj gjykate C.nr.925/2021, me numër të lëndës 2020:021007, të datës 14.12.2021, është kompensuar në emër të ushqimit në punë, as këto pretendime nuk qëndrojnë për faktin se gjykata ka verifikuar që periudha e cila është kompensuar nuk është e njëjtë, paditësja V.S-R është kompensuar për periudhën 2017-2019, ndërsa periudha të cilën e kërkon me kërkespadi është 22.01.2021-21.01.2022.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve për faktin se paditësit në periudhën kohore nga data 22.01.2021e deri më 21.11.2022, në vendin e tyre të punës kanë prezantuar paditësi V.D, M.K dhe V.S-R, për 331 ditë të punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të

lëshuar nga vetë shkolla ku paditësit kanë qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti e ka kontestuar e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merit, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palës së paditur, por nuk ishin relevante në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore.

Vendimin lidhur me kumatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyq fituese, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 228,00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 208 euro si dhe për taksën gjyqësore 20.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1165/2023, më datën 20.06.2024

B.Profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.